

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Ferit Osmani, anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.S., nga Komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.730/18 të datës 17.04.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 22.08.2019, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.730/18 të datës 17.04.2019, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.730/18 të datës 17.04.2019, të akuzuarin G.S., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dhe njëkohësisht i është caktuar se dënimi me burgi nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit të ankimuar nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve proceduralë të paguaj shumën prej 15 €, në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 15 €, të gjitha këto nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe ndaj të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me burg të paraparë me Kodin Penal , konform me pretendimet në ankesë.

Prokurori i Apelit, me shkresën, PPA/II nr.1012/2019 datë 19.08.2019 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal, në atë mënyrë që të akuzuarit, ti shqiptohet një dënim me burg.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**- Ankesa nuk është e bazuar**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me anë të aktit akuzues dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve të paraqitura në ankesë.

Sa i përket vendimit mbi dënim, në ankesë prokurori pretendon se, gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar drejtë ka vepruar kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale të kryer, mirëpo gjatë përcaktimit të lartësisë së dënimit është nxjerr konkluzion i gabuar nga arsyeja sepse dënimi i shqiptuar është shumë i butë dhe jo adekuat në krahasim me veprën penale të kryer, sidomos duke pasur parasysh pasoja konkrete dhe rrezikshmërinë shoqërore nga vepra penale e kryer. Prokuroja në ankesë ka theksuar se gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal e cila kundër të akuzuarit do të zbatohet, gjykata e shkallës së parë ka çmuar rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në përcaktim, llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, ndërsa nga rrethanat lehtësuese ka marrë parasysh në favor të akuzuarit, qëndrimin e tij korrekt pranë gjykatës, që me pranimin e tij ka kontribuar në vërtetimin e gjendjes faktike dhe se është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rrethana rënduese për të akuzuarin nuk ka gjetur. Prokurori në ankesë ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka çmuar rrethana

lehtësuese në favor të akuzuarit, mirëpo ka gabuar duke theksuar se nuk ka rrethana rënduese në anë të akuzuarit, andaj dhe nuk i ka çmuar në mënyrë adekuate rrethanat rënduese të cilat veçanërisht pasqyrohen me faktin se veprat penale vjedhje janë në rritje konstante dhe të konsiderueshme dhe se në rastin konkret bëhet fjalë për pronë private dhe vjedhja e lëndës është kryer në dëm të pronës private dhe nuk ka çmuar në mënyrë adekuate as shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Po ashtu, në ankesë thekson se me dënim të shqiptuar ndaj të akuzuarit si në aktgjykimin e ankimuar nuk do të arrihet qëllimi i dënimit dhe se dënimi nuk është proporcional me shkallën e fajësisë së pandehurit, me faktin se i akuzuarit ka kryer veprën penale me dashje direkte dhe në një gjendje të aftë mendore, si me pasojë të rezultuar dhe gjithashtu nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit në fushën e parandalimit të përgjithshëm dhe nuk do të ndikoj tek i akuzuari si dhe te personat të tjerë që të mos kryejnë vepra penale të kësaj natyre. Prokurori pretendon se nëse gjykata do të kishte vlerësuar në mënyrë adekuate rrethanat rënduese në anë të akuzuarit, gjithsesi do ta kishte shqiptuar një dënim tjetër më të rëndë veçanërisht duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana inkriminuese të akuzuarit në kryerjen e veprës penale.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e prokurorit, që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me burg të paraparë me Kodin Penal, konform me pretendimet në ankesë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 74 të KPRK-së, gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit me ç' rast si rrethana lehtësuese nga ana e të akuzuarit, mori pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte para gjykatës, se me pranimin e tij ka kontribuar në vërtetimin e gjendjes faktike dhe që është në gjendje të dobët materiale, ndërsa rrethana rënduese në anën e të akuzuarit gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtyre rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar faktin se i akuzuari ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën e cila i është vënë në barrë me anë të aktit akuzues, se në ankesën e prokurorit nuk ceket ndonjë rrethanë tjetër që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë me burg efektiv, të cilat i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë si dhe duke vlerësuar kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale, kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky

dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, e duke pasur parasysh se i akuzuari është gjykuar me dënim sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e neni 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr. 996/2019 me datë 22.08.2019**

**Zyrtari ligjor**  
**Shaban Prekalla**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
**Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit:**

- 2. Shqipe Qerimi**
- 3. Ferit Osmani**